



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr.172, Datë 04.11.2020

“MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË
“ENERGIA GAS AND POWER ALBANIA” SH.P.K., NR. 322, SERIA F15, NË
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË MIRATUAR
ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S, NR. 159, DATË
28.12.2015”.**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma ç) të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma d); nenit 5, pika 1, gërma d); nenit 8, nenit 9, nenit 10, pikat 1 dhe 3 dhe nenit 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 19 pika 1, gërma “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e datës 04.11.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 116/9 prot, datë 02.11.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, mbi kërkesën e shoqërisë “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

Konstatohet se:

- Shoqëria “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr.1067 prot, datë 22.10.2020, ka aplikuar për rinovimin licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, nr. 322, Seria F15, miratuar me vendimin e bordit nr. 159, datë 28.12.2015.
- Kjo shoqëri është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. Në datën 11.06.2014 është e regjistruar pranë QKB, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k), konform ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për qendrën kombëtare të biznesit” (QKB), dhe mban NUIS përkatës.
- Në nenin 16, pika 1, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, e ndryshuar,

përcaktohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo me vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë.

- Sa më sipër, vlefshmëria e licencës së shoqërisë “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike përfundon në datën 28.12.2020 dhe shoqëria e ka depozituar aplikimin e saj në ERE, brënda afatit që përcakton neni 16, pika 1, sipërcituar, (datë 22.10.2020).
- Aplikimi i shoqërisë “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, si më poshtë:
 - Formatimi dhe dokumentacioni për aplikimin (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” “c”) **është plotësuar tërësisht.**
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”) **është plotësuar pjesërisht.**
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”), **është plotësuar pjesërisht.**
 - Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”) **është plotësuar pjesërisht.**

Për dokumentacionin e munguar apo të plotësuar pjesërisht që ka të bëjë me:

Dokumentat juridike, administrative dhe pronësore

Neni 9, pika 2:

- **gërma “d”** (Vërtetim që shoqëria dhe drejtuesit kryesorë të saj në rastin e personave juridikë, nuk janë të përfshirë në një proces penal të filluar nga organet e drejtësisë (vërtetim nga prokuroria dhe gjykata). Shoqëria “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k. duhet të përcjellë në ERE vërtetimet e gjykatës dhe prokurorisë për të deleguarin përgjegjës.

Dokumentat financiare dhe fiskale, sipas

Neni 9, pika 3 :

- **gërma “a”** (Vërtetim për shlyerjen e Tatim – taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve shoqërore (për shoqëritë e sapokrijuara vërtetim që nuk ka detyrime). Do t’i kërkohej shoqërisë të dokumentojë në ERE kryerjen e pagesës ndaj Drejtorisë rajonale të tatimeve Tiranë për kontributet, e cila sipas vërtetimit nuk përmban as kamatvonesë dhe as gjobë.

Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike sipas

Neni 9, pika 4.7:

- **gërma “e”** (Sistemin IT të krijuar për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike apo marrëveshje me të tretët për vënien në dispozicion/përdorimin e këtij shërbimi). Shoqëria “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k. duhet të përcjellë në ERE marrëveshjen për sistemin IT që ka me Microsoft.

do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 10 dhe nenit 11, pika 1 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 306, Seria FK15, të shoqërisë “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të ERE Nr. 159, datë 28.10.2015, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 29.12.2020.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI